



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 239, Datë 30.09.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 296, DATË 30.12.2024
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARKU FOTOVOLTAIK “BLUE 2”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2426/1 prot., datë 26.09.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik “BLUE 2”, me kapacitet të instaluar 50 MW”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 296, datë 30.12.2024, ka licencuar shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke përcaktuar si më poshtë vijon:
1. Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar, duke filluar nga momenti i energjizimit të veprës, por jo më vonë se data 17.03.2026. 2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. me shkresën protokolluar në ERE me nr. 2457/1 prot., datë 22.09.2025, ka paraqitur kërkesën për të konsideruar si datë të fillimit të afatit të licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. me nr. serie P24 dhe nr. licence 603.
- Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. me shkresën e datës 08.09.2025, protokolluar në ERE me nr. 2426 prot., datë 09.09.2025, ka depozituar në ERE njoftimin mbi energjizimin e parkut fotovoltaik “Blue 2”, duke bërë me dije se nga data 11.08.2025 parku fotovoltaik Blue 2 është energjizuar për fazën e parë.
- Me shkresën e datës 15.08.2025, protokolluar në ERE me nr. 2335 prot., datë 19.08.2025, shoqëria ka depozituar në ERE njoftimin mbi nënshkrimin me OST sh.a. të marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit me nr. 4333 prot., datë 13.08.2025 dhe atë të palës përgjegjëse për balancim me nr. 4288 prot., datë 13.08.2025, si dhe fillimin e procesit të

energizimit më datë 12.08.2025, në koordinim me ekipin e OST, duke vijuar me provën 72-orëshe dhe futjen në skemën e prodhimit të energjisë hap pas hapi.

- Nga ana tjetër, në vijim të raportimeve periodike në zbatim të licencës së operimit të sistemit të transmetimit, OST sh.a. në raportimin e muajit gusht 2025 ka bërë me dije se shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. ka prodhuar sasinë prej 5332.4 MWh gjatë këtij muaji, fakt i cili konfirmon deklarimin e bërë nga shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k..

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Me shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k., vlerësohet se pikat 1 dhe 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024, duhet të ndryshohen. Efektet për llogaritjen e datës së fillimit të licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. do të fillojnë nga data 13.08.2025, si data e nënshkrimit mes palëve të marrëveshjes për operimin e rrjetit të transmetimit.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 1 dhe 2 të dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024, duhet të ndryshohen, pasi shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. ka përmbushur kushtet përkatëse dhe afatet e reja duhet të reflektojnë situatën aktuale të realizimit të projektit.
- Për sa më sipër pika 1 e vendimit nr. 296/2024 është: *“Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar, duke filluar nga momenti i energjizimit të veprës, por jo më vonë se data 17.03.2026.”* vlerësohet të bëhet: *“Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar, duke filluar nga data 13.08.2025.”*
- Pika 2 e vendimit të bordit të ERE nr. 296, datë 30.12.2024, shfuqizohet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 1 e vendimit të bordit të ERE nr. 296, datë 30.12.2024, ndryshon dhe bëhet si më poshtë vijon: *“Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar, duke filluar nga data 13.08.2025.”*
2. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE nr. 296, datë 30.12.2024, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe OST sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI